



NJOFTIM PËR SHTYP

Për të ulur humbjet e ujit, ndërmarrjet publike komunale (NPK) duhet të investojnë në infrastrukturë, në digjitalizim dhe në efikasitetin energjetik - tha Aco Ristov, kryetar i Komisionit Rregullator të Energjetikës, të Shërbimeve të Ujit dhe të Shërbimeve të Menaxhimit me Mbeturina Komunale (KRrE) në panelin "Përdorimi i Rrjetit të Ujësllësit", në suaza të nisjes zyrtare të projektit "Ndërmarrje Komunale Rezistente dhe Efikase në Maqedoni".

Kryetari Ristov theksoi se secili investim për rritjen e efikasitetit të ndërmarrjeve publike komunale nga KRrE-ja do të miratohet, por paralajmëroi se realizimi do të përcillet.

"Ju inkurajoj të investoni. Por kini kujdes, realizimi i investimeve do të përcillet përmes një sërë indikatorësh të efikasitetit: se a do të ketë ulje të humbjeve të ujit, se a do të rritet arkëtimi. Ka analiza që indikojnë se me vendosjen e digjitalizimit, mund t'i ulni kostot për 10 deri më 15 përqind. Me uljen e konsumit të energjisë elektrike, shpenzimet ulen në mënyrë të konsiderueshme. Ne si KRrE po ndërmarrim hapa që të mund të rritet pavarësia energjetike në nivel mikro - edhe te komunitat, mes të cilave janë edhe NPK-të. Ideja është që komunitat të mund të themelojnë shoqëri për prodhimin e energjisë elektrike, përmes të cilës do të mundën në mënyrë të pavarur ta menaxhojnë, ta depozitojnë dhe ta shesin tepricën e energjisë për nevojat e njësisë së vetëqeverisjes lokale," theksoi Aco Ristov, kryetar i KRrE-së.

Projekti "Ndërmarrje Publike Komunale Rezistente dhe Efikase" u financua nga Qeveria e Konfederatës Zvicerane dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor si dhe nga një pjesë e komunave. Realizimi i projektit ka për qëllim ta përmirësojë punën operative dhe financiare të NPK-ve, si dhe ta rrisë efikasitetin energjetik përmes zbatimit të zgjidhjeve efikase për menaxhim të qëndrueshëm me resurset e ujit.

9.6.2026



ул. Македонија бр. 25, палата Лазар Поп-Трајков - 6^{тм} спрат • 1000 Скопје,
Република Северна Македонија
Централа 02 3233-580 • Факс: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk

Rr. Maqedonia nr. 25, pallati L Lazar Pop-Trajkov – kati i 6 • 1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut
Qendra 02 3233-580 • Faks: 02 2556 004 • www.erc.org.mk • e-mail: erc@erc.org.mk